



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

KKDM/Nr. ....**125**..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 11 / 2022

**VENDIM**

Nr.30, date 21 /11/2022

**PËR**

**KËRKESËN PËR DHENIE MENDIMI NE LIDHJE ME VLERESIMIN E RISKUT NGA  
FATKEQËSITE NË NIVEL QËNDROR**

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirimbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.11.2022 mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit te Mbrojtjes per dhenie mendimi ne lidhje me vleresimin e riskut nga fatkeqesite ne nivel qendoror e prezentuar nga Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile (AKMC). Ne mbledhje ishin prezant perfaqesues te AKMC si dhe konsulentit qe ka prezentuar vleresimin e riskut nga fatkeqesite ne nivel qendoror ne rastin e carjes se digave.

Gjatë diskutimeve, te gjithe antaret prezant te KKDM theksuan faktin e rendesise se 351 digave te medha dhe rriskut te larte te tyre ne rastet e ndonje prishje te mundshme te tyre apo prurjeve maksimale te mundshme qe mund te vijne ne rezervuaret e krijuar prej tyre. Ne keto diskutime u theksua jo vetem rendesia e vecante e digave te shprehura ne legjislacionin perkates por edhe pasojat qe mund te shkaktohen nga keqshfrytezimi i tyre apo prishjeve te mundshme. Shqiperia me 351 diga te medha, eshte nder 20 vendet qe kane me shume diga ne bote.

Sipas analizave te kryera nga KKDM rezulton se ne rastet e prishjes se mundshme te 10 digave me te medha te vendit tone me lartesi mbi 60 m, me se 330 000 njerez jane ne rrezik per humbjen e jetes.

Sipas studimeve te kryera nga KESH, në rast te prishjes së një prej digave te kaskades se lumit Drin, afro 190 000 njerez jane ne rrezik per humbjen e jetes. Ne kete rast demet ekonomike jane shume te medha dhe me efekte ekonomike negative per periudha te gjata.

Perfaqesuesi i Konsulentit te AKMC sqaroi se në studimin e kryer prej tyre për riskun nga carjet e digave ishin marre në konsiderate faktoret e riskut te larte ne lidhje me humbjen e njerezve por per shkak te mungesës se te dhenave, nuk ishin marre në konsiderate faktoret e rriskut te larte ne lidhje me humbjet ekonomike ne rast te prishjes se mundshme te digave.

Pas diskutimeve te gjithe antarëve te pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratoj Raportin e Konsoliduar per vleresimin e Riskut te Fatkeqesive ne Shqiperi te prezentuar nga Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile ne lidhje me carjet e digave.
- 2- Ti kërkojë Ministrise se Mbrojtjes dhe Agjencise Kombetare te Mbrojtjes Civile:
  - Rivleresimin e Raportit te Konsoliduar per Vleresimin e Riskut te fatkeqesive ne Shqiperi ne lidhje me carjet e digave duke marre ne konsiderate legjislacionin ne fuqi i cili percakton digat e medha si vepra te rendesise se vecante, analizen ekonomike dhe teknike per vleresimin e riskut ne lidhje me carjet e digave, analizen dhe perfundimet e KKDM ne lidhje me rriskun e larte te fatkeqesive nga prishja e mundshme e ndonje dige te madhe, prurjeve maksimale te mundshme qe mund te vijne ne rezervuaret e krijuar prej tyre apo keqshfrytezimi i digave te mëdha prej përdoruesve te tyre. Bazuar në detyrat dhe legjislacionin ne fuqi, KKDM duhet te perfshihet ne grupet kryesore te interesit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Pregatitjen e një Raporti te vecante specifik per vleresimin e riskut nga prishja e mundshme e digave, keqshfrytezimi i tyre dhe prurjet maksimale te mundshme. Pergatitja e ketij rapporti eshte e lidhur me rendesine e vecante te digave si dhe riskun e larte te fatkeqsive prej prishjes se tyre

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjisacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

